



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 924/20
Data/Datumi 14.12.20

PRISHTINE - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.924/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, ne përbërje të Z. Blerim Dina - Kryetar, panelist individual duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “NAS SYSTEMS” SH.P.K, & TETRONIKS ” L.L.C., Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik DPT “Pro-Computers”-Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja dhe servisimi i kamerave publike qytetit CCTV”, me nr. të prokurimit: 651-20-3120-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-GJILAN”, më datën: 14.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “NAS SYSTEMS” SH.P.K, & TETRONIKS” L.L.C. Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja dhe servisimi i kamerave publike qytetit CCTV”, me nr. të prokurimit: 651-20-3120-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-GJILAN”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dhe servisimi i kamerave publike qytetit CCTV”, me nr. të prokurimit: 651-20-3120-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-GJILAN”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "NAS SYSTEMS" SH.P.K. & TETRONIKS " L.L.C., Gjilan, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "NAS SYSTEMS" SH.P.K & TETRONIKS " L.L.C. Gjilan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 12.11.2020 me nr. 924/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe servisimi i kamerave publike qytetit CCTV", me nr. të prokurimit: 651-20-3120-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK-GJILAN", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 28 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 02.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, NJK, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize mendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, nenin 59.

Eksperti shqyrtues teknik pas analizimit të dokumentacioneve sqaron se OE i shpallur fitues nuk i plotëson kriteret për të shpallur fitues sipas NJK, DT dhe Specifikimit Teknik.

OE DPT "Pro – Computers" me seli në Gjilan me oferte financiare sipas vlerës peshuese : 552.44 Euro i mungojnë dhe ka probleme si vijon:

1. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare: 8.1 & 8.2

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktuese si qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik gjatë 3 vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) ka qenë jo më pak se 150,000.00 Euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2. Deklaratat Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhurave ose Korporata ose Pasqyrat Financiare të Audituar nga Auditori i Licencuar

OE DPT "Pro – Computers" i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar vetëm Deklaratat për vitin 2017, dhe si të tilla vlera e tyre arrijnë 60,520.46 Te ardhura bruto PD, ndërsa kërkesa nga AK në DT, NJK ka qenë vlera totale për tri vitet para njoftimit për kontratë jo më pak se 150,000.00 Euro

Në rastet kur OE apo grupet e OE dorëzojnë deklaratat mbi mundësitë e gjendjes ekonomike dhe financiare por dokumentacionet e dorëzuara nuk i përmbushin kërkesat të cilat janë të precizuara në DT, NJK atëherë AK dhe komisioni i vlerësimit në pajtim me Nenin 68 janë të obliguar të refuzojnë tenderin. Në pajtim me RROUP. Në rastin në fjalë OE DPT "Pro-Computers" ka dorëzuar: dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale / Refuzo Tenderin Pa Kërkuar Informacione Shtesë / Në Pajtim Me Nenin 68

Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Mund të kërkojnë informata shtesë	68
Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.	68

PD FORMULARI I DEKLARIMIT VJETOR DHE PAGESËS PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE




MFA2F80219184913

[1] Periudha e Deklarimit:	2017	
[3] Numri Fiskal:	810286395	[3a] Numri Personal: 1030744027
[4] Emri i biznesit/individit:	Arlind Kqiku B.I.	
[5] Adresa e biznesit/individit:	28 NËNTORI	
[6] Telefoni:	044211287 44211287	[6a] Kodë primar i veprimtarisë: 4754


Të ardhurat e tatueshme		
[8] Pagat bruto:	[8]	0.00
[9] Të ardhurat neto nga biznesi nga kutia 78 e DF.....[9]		3,744.54

Tatimi i mbajtur në burim gjatë vitit		
[31] Tatimi i mbajtur në burim në paga nga punëdhënësit (bashkëngjijtë certifikatat)	[31]	0.00
[32] Tatimi i mbajtur në burim mbi interesin		

**FORMULARI I DEKLARIMIT VJETOR DHE PAGESES PËR
TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE**

[1] Periudha e Deklarimit:	2017	 MFA2F80219188153
[3] Numri Fiskal:	810286395	[3a] Numri Personal: 1030744027
[4] Emri i biznesit/individit:	Arlind Kqiku B.I.	
[5] Adresa e biznesit/individit:	28 NËNTORI	
[6] Telefoni:	044211287 44211287	[6a] Kodi primar i veprimtarisë: 4754

**FORMULARI I DEKLARIMIT VJETOR DHE PAGESES PËR
TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE**

[1] Periudha e Deklarimit:	2017	 MFA2F8021919083T
[3] Numri Fiskal:	810286395	[3a] Numri Personal: 1030744027
[4] Emri i biznesit/individit:	Arlind Kqiku B.I.	
[5] Adresa e biznesit/individit:	28 NËNTORI	
[6] Telefoni:	044211287 44211287	[6a] Kodi primar i veprimtarisë: 4754

2.OE DPT “Pro – Computers” pas analizes dhe kontrollimit te listes se cimore, bazuar ne cmimet e tregut ka vendosur cmimce te cilat nuk jane cmime te cilat jane reale dhe eshte e pamundur te realizohet furnizimi dhe servisimi per te gjitha artikujt me cmimet e ofruara. OE ne fjale ka vendosur cmim per artikullin nr. 16 Server profesional i brendit DELL EMC modeli 650 cmimi 200 euro, perderisa cmimi real i tij ne tregun e distribuimit me shumice varion nga 2,500.00 deri 4,500.00 Euro. Ngjashem eshte per artikullin nr. 1, dhe tjeret ne pjesen e listes se furnizimit. Perderisa tek lista e servisimit ka vendosur cmime per riparimin dhe servisimin e 11 nga artikuj vlera totale per njesi nga nje eshte 7 euro. Keto cmime jane cmime manipuluese per pjeset e Furnizimit dhe Servisit. Tek pjesa e Sherbimit ka vendosur cmime te cilat jane me te larta se ne dy pjeset tjera. P.sh. ka vendosur qe te ofrohet me cmim 30.00 euro per zhvendosje te kabllit optik per njesi meter. Etj. Cmimet te cilat jane ne kete oferte jane cmime tendencioze dhe nuk sigurojne qe mjetet e Buxhetit te Kosoves do te shfrytezohen ne pajtim me nenin 1 dhe nenin 6.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1:

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE “NAS SYSTEMS” SH.P.K, & TETRONIKS” L.L.C. Gjilan Se nuk ka dorëzuar kontrata per aneksin 6.

OE DPT “Pro – Computers” ka dorezuar Listen e Kontratave me daten e nenshkrimeve , gjithashtu OE ka

bashkangjitur dhe kontratat me daten e nenshkrimit, daten e perfundimit adresat dhe emailat se bashku me kontaktet e punedhensëve ne dokumentin tjetër tek **07. Kontratat dhe referencat.pdf**.

Gjithashtu ne baze te aneksit 6 AK eshte dashur te kerkoj deshmi shtese nga OE per vertetimin e kontratave dhe referencave , pasi te njejtat nuk korespondojne me referencat sipas vleres dhe nuk kane raport bankar apo deftese te pageses per referencen. Perderisa kontratat dhe sherbimet nga klientet private, referenca per te qene valide duhet te kete edhe deshmine e pageses. Andaj ky pretendim është pjesërisht i bazuar *Dëshmia e OE per kontratat .*

Aneksi 6. Lista e kontratave te realizuara ne 3 vjetet e fundit

(Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë)

NR	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e perfundimit të kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Klientit	Email i Klientit	Numeri i telefonit të Klientit
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							

(Shënojeni sipas nevojës)

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërejtet ndonjë dyshim të rreme, ofendë e tillë do të konsiderohet si një ofendë e pa përgjegjësi dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të lëkëtohet nga Departamenti i Prokurimit për të vjetër në listën e zezë të Operatorëve Ekonomikë.

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Lista e kontratave te realizuar

NR	Emri i projektit	Nr prok	Vlera	data	Vendi
1	Furnitimi me 8 pa rat fotokopjues, printer dhe skaner per te gjitha njezit dhe punonjese ne Komandën e Gjilanit	GRN/18/020-121	89,160.00	05.12.2018	Gjilan
2	Kontrata: Ofrimi i shërbimit të IT dhe furnitimi (PC, Printer, periferike, BEID)	/	20,000.00	30.05.2018	Flutur Gjilan
3	Policia e Kosovës, EOM - CCTV	04/1-066/387/2019	Donacion	06.12.2019	Policia e Kosovës Gjilan
4	Furnitimi dhe shërbimi me: pc, server, printer, fotokopjues, toner, CCTV, FIBER, LAN	Flutur	29,000.00	03.01.2018	Flutur Gjilan
5	Furnitimi dhe shërbimi me: pc, server, printer, fotokopjues, toner, CCTV, FIBER, LAN	Flutur	45,000.00	01.07.2019	FLUTUR Gjilan

21.07.2020 Gjilan



Deshmitë e kontakteve



Punuar dhe pergaditur nga:
Jeton Lakoni
Viv. Asistent Administrativ

Skedar Komandantit të stacionit policor në Gjilan
Komandanti komandant stacioni policor në Gjilan
Station commander office Police station in Gjilan

Tel: 020 420 000
Fax: 020 420 000

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE “NAS SYSTEMS” SH.P.K, & TETRONIKS " L.L.C., Gjilan mbi shkeljet nga AK sqaron se ne dosjen elektronike te dorezuar ne e-prokurim OE DPT “Pro – Computers” ka ofruar kontrata te realizuara per CCTV , te njejtat referenca i posedon nga dy kompani private, dhe meqenese referencat jane te leshuara per instalime, konfigurime dhe furnizime CCTV, mirepo te njejtat nuk jane instalime, furnizime te CCTV ne qytet (por Polici, Kompani Private etj) 07. Kontratat dhe referencat.pdf



University of
 Worcester
 Worcester, MA
 01601-0001
 (508) 853-2000

2005年10月10日

Cardinalis 12/17, Galen

Nel caso di contestazione dell'atto di accertamento, l'organo competente è quello che ha emesso l'atto stesso.



LENDV = LETTER DIFFERENCE

12466

books. ROM CC TV is one to provide answers to the fundamental questions of what the major objectives of this and other modules in the curriculum framework are, the scope of the course in terms of its A-level (37%) + E-level (63%) components, pre- and post-course study, whether or not to study in groups, etc., and the various forms of assessment.

Nel documento si riconoscono anche alcuni nomi di città: Kijot, un villaggio nei pressi di Chikobani, e Chikobani. Ma le informazioni relative Chikobani non si trovano in nessuna delle altre fonti e sembra che non siano mai esistite.

J. Appl. Kines. is published twice for the month. All articles submitted to *J. Appl. Kines.* should be sent to the Editor at the address given below.

AK – KK Gjilan dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar ne kundërshtim me Nenin1, Nenin6, Nenin7, Nenin 59 te LPP

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht të bazuar , te Anullohet vendimi i AK i datës 23.10.2020 dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim

Autoriteti Kontraktues, me datë: 03.12.2020, me të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Nuk Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 02.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues,

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “NAS SYSTEMS” SH.P.K, & TETRONIKS " L.L.C., se pas analizimit të dokumentacionit, se OE i shpallur fitues nuk i plotëson kriteret për tu shpallur fitues sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit dhe specifikimit teknik. OE DPT “Pro – Computers” me seli në Gjilan me ofertë financiare sipas vlerës peshuese: 552.44 Euro i mungojnë dhe nuk i plotëson kriteret si në vijim:

2. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare: 8.1 & 8.2

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 1.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktuese si qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik gjate 3 vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontratë)ka qen jo me pak se 150,000.00 Euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 2. Deklaratat Tatimore Vjetore te Tatimit ne te Ardhurave ose Korporata ose Pasqyrat Financiare te Audituar nga Auditori i Licencuar

OE DPT “Pro – Computers” i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar vetëm deklaratat për vitin 2017 dhe si të tilla, vlera e tyre arrin 60,520.46 të ardhura bruto PD, ndërsa kërkesa nga AK në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë ka qenë vlera totale për tri vitet para njoftimit për kontratë jo më pak se 150,000.00

Euro. Në rastet kur OE apo grupet e OE dorëzojnë deklarata mbi mundësitë e gjendjes ekonomike dhe financiare por dokumentacionet e dorëzuara nuk i përmbushin kërkesat të cilat janë të precizuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, atëherë AK dhe komisioni i vlerësimit në pajtim me nenin 68 janë të obliguar ta refuzojnë tenderin në pajtim me RROUP. Në rastin në fjalë OE DPT "Pro-Computers" ka dorëzuar: dëshmitë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk përmbushin kërkesat minimale / Refuzo tenderin pa kërkuar informacione shtesë / në Pajtim me nenin 68.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se OE DPT "Pro – Computers" ka dorëzuar listen e kontratave me datën e nënshkrimeve, gjithashtu OE ka bashkangjitur dhe kontratat me datën e nënshkrimit, datën e përfundimit, adresat dhe emailat së bashku me kontaktet e punëdhënësve ëe dokumentin tjetër tek **07. Kontratat dhe referencat.pdf**. Gjithashtu, në baze të aneksit 6 AK është dashur të kërkoj dëshmi shtesë nga OE për vërtetimin e kontratave dhe referencave, pasi të njëjtat nuk korrespondojnë me referencat sipas vlerës dhe nuk kanë raport bankar apo dëftesë të pagesës për referencën. Përderisa kontratat dhe shërbimet nga klientët privat, referenca për të qenë valide duhet të ketë edhe dëshminë e pagesës. Andaj ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Në lidhje me pretendimin tjetër të OE ankaues "NAS SYSTEMS" SH.P.K, & TETRONIKS " L.L.C., se pas analizeës dhe kontrollimit të listës së çmimore, bazuar në çmimet e tregut ka vendosur çmime të cilat nuk janë çmime të cilat janë reale dhe është e pamundur të realizohet furnizimi dhe servisi për të gjithë artikujt me çmimet e ofruara. OE në fjalë ka vendosur çmim për artikullin nr. 16 Server profesional i brendit DELL EMC modeli 650 çmimi 200 euro, përderisa çmimi real i tij ne tregun e distribuimit me shumicë varion nga 2,500.00 deri 4,500.00 Euro. Ngjashëm është për artikullin nr. 1, dhe tjerët në pjesën e listës së furnizimit. Përderisa tek lista e servisit ka vendosur çmime për riparimin dhe servisin e 11 nga artikuj vlere totale për njësi nga një është 7 euro. Këto çmime janë çmime manipuluese për pjesët e furnizimit dhe servisit. Tek pjesa e shërbimit ka vendosur çmime të cilat janë më të larta se në dy pjesët tjera. P.sh. ka vendosur që të ofrohet me çmim 30.00 euro për zhvendosje të kabllit optik për njësi metër. etj. Çmimet të cilat janë në këtë ofertë janë çmime tendencioze dhe nuk sigurojnë që mjetet e Buxhetit të Kosovës do të shfrytëzohen në pajtim me nenin 1 dhe 6. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE "NAS SYSTEMS" SH.P.K, & TETRONIKS " L.L.C., Gjilan mbi shkeljet nga AK sqaron se në dosjen elektronike të dorëzuar në e-prokurim nga OE DPT "Pro – Computers" ka ofruar kontrata të realizuara për CCTV, të njëjtat referenca i posedon nga dy kompani private, dhe meqenëse referencat janë të lëshuara për instalime, konfigurime dhe furnizime CCTV, mirëpo të njëjtat nuk janë instalime, furnizime të CCTV në qytet (por Polici, Kompani Private, etj.). Andaj ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e radhës të OE ankues "NAS SYSTEMS" SH.P.K, & TETRONIKS " L.L.C., Paneli

Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik lidhur me pretendimin ankimor të OE "NAS SYSTEMS" SH.P.K. & TETRONIKS " L.L.C., Gjilan se OE i rekomanduar për kontratë OE DPT "Pro – Computers" nuk ka dorëzuar të kompletuar katalogun dhe broshurat sipas kërkesës në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik pas verifikimit sqaron se katalogët dhe broshurat nuk janë të kompletuara për të gjitha artikujve. Ky pretendim është i bazuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se as OE "NAS SYSTEMS" SH.P.K. & TETRONIKS " L.L.C., Gjilan nuk ka dorëzuar sigurimin e tenderit sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe si OE është i papërshtatshëm dhe nuk i plotëson kriteret të shpallet fitues sipas nenit 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se as DPT "Pro – Computers" nuk i përmbush kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe pretendimet tjera ankimore si OE është i papërshtatshëm, dhe nuk i plotëson kriteret të shpallet fitues sipas nenit 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka pasur në konsideratë nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së, si dhe nuk e ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK Gjilan";
- 1x1 OE "NAS SYSTEMS" SH.P.K. & TETRONIKS " L.L.C. Gjilan;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.